



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

"ÇABRATI" SH.A. - JSC:DD.
GJAKOVË

Nr. No. Dd. 662 Strana 1

Dt. 28.03.2024

Tel. +383(0)390/321 588

+383(0)390/324 034

+383(0)46 19 55 55

www.cabrati.com

e-mail: info@cabrati.com

Gjakovë - Gjakova

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE
"ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË

RAPORT VJETOR
JANAR – DHJETOR 2023

PËRMBAJTJA

1. KRM "ÇABRATI" – INFORMATAT E PËRGJITHSHME.....	3
1.1 Vizioni.....	4
1.2 Misioni.....	4
1.3 Qëllimet e kompanisë.....	4
1.4 Aktivitetet.....	5
2. AKTIVITET PRIMAR I KOMPANISË.....	5
3. AKTIVITETET SEKONDARE.....	7
3.1 Varrezat e Qytetit.....	7
3.2 MARRËVESHJA ME KOMUNËN E GJAKOVËS.....	7
4. RAPORT MBI AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË OPERATIVES GJATË VITIT 2023.....	8
4.1. PAISJET/ MAKINERITË.....	9
4.2 KRM "Çabrati" Sh.A operon në këto orar:.....	11
5. SEKTORI PËR INKASIM/ FATURIM dhe MARRËDHËNIE ME KONSUMATORË.....	11
6. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2023.....	14
6.1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	14
6.2 KORNIZA LIGJORE.....	14
6.3 AKTIVITETI PËR PERIUDHËN RAPORTUESE.....	15
6.4 REKOMANDIMET/SFIDAT E ZYRES PROKURIMIT.....	20
6.5 RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA AUDITORIT JASHTËM.....	22
7. KOMUNIKIMI / PLANIFIKIMI / RAPORTIMI.....	24
8. PJESA JURIDIKE DHE ADMINISTRATIVE.....	25
8.1 RAPORT MBI RASTET GJYQËSORE, AKTIVE DHE QË KANË PËRFUNDUAR GJATË VITIT 2023.....	26
9. PERSONELI / BURIMET NJERËZORE.....	30
10. PJESA FINANCIARE – TË HYRAT DHE SHPENZIMET.....	33

1. KRM "ÇABRATI" – INFORMATAT E PËRGJITHSHME

Ky raport paraqet aspektet kryesore operacionale të menaxhimit dhe udhëheqjes në KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë, për periudhën Janar-Dhjetor 2023. Aksionar kryesor i Kompanisë me 100 % aksione është Komuna e Gjakovës. Kompania ushtron veprimtarin e saj sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës (Ligji Nr. 06/L-016) Ligjit Për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087), Ligjit Për Mbeturina (Ligji Nr. 04/L-060) i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2012) dhe Statutit të KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.

Mbikëqyrja e KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë, bëhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe Bordi Drejtorëve, kurse udhëheqja e kompanisë bëhet nga Stafi Menaxhues (Zyrtarët e lartë dhe zyrtarët tjerë). Veprimtaria e kompanisë ushtrohet kryesisht me mjete vetanake si për veprimtari primare dhe ajo sekondare kryesisht me kontrata apo marrëveshje me Komunën e Gjakovës. KRM "Çabрати" Sh.A. në vitin 2023 ka pasur këtë strukturë të punëtorëve 55.39% të komunitetit shqiptar dhe 44.61% janë të komunitetit RAE. Selia e Ndërmarrjes është e ndarë në dy njësi: njësia qendrore - drejtoria me seli në rrugën "Mazllom Lakuci" dhe njësia teknike (Operativa) e cila ndodhet në objektin e "Ish-Policia e Vjetër" rruga Nëna Terezë. Përpos selisë qendrore dhe operative, kemi në shfrytëzim me të drejtë shfrytëzimi edhe objektin e "Varrezave të Qytetit" në lagjen "Brekoc" dhe objektin "Stacioni transferues i mbeturinave" në lagjen "Ali Ibra" me afat shfrytëzimi 5 /pesë/ vjeçar. Krahas Stacionit Transfer përgjatë vitit 2021 është përfunduar edhe Oborri Riciklues i cili është fituar grandit me BE IPA II kross Border Kosovë-Mali i Zi. Gjithashtu kompania përgjatë vitit 2023 ka në shfrytëzim lokacionin tek çerdhja "Ganimete Terbeshi" pikë e shitjes në shfrytëzim për 2 vite dhe Tregun e Gjelbër që gjendet në rrugën "Yll Morina" në marrëveshje me Komunën e Gjakovës.

Kompania ofron tri lloje të shërbimeve të bartjes së mbeturinave: konsumatorët e ekonomive familjare, (amvisëritë), bizneset e vogla, të mesme dhe ato të mëdha, si dhe institucionet (Shkollat, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Qendrat e mjekësisë Përgjithshme-Spitalit Rajonal, Qendrat Kulturore e Sportive, Muzetë, Entet, Ndërmarrjet Publike etj.). Konsumatorët e amvisërive ndahen në dy kategori, në ato që e pranojnë shërbimin "derë më derë" dhe ata të cilët shërbejnë apo janë të pajisur më kontejnerë. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin në vijueshmëri me apo pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve, që zakonisht janë të shërbyera me kontrata të veçanta me kontejnerë të veçantë të vëllimit 1.1m.

1.1 Vizioni

Qyteti i pastër mirëmbajtja e tij është përgjegjësi e secilit e në veçanti i Ndërmarrjes Çabрати;

Shërbimet kualitative në kohë dhe konsumator të kënaqur me shërbimet e kompanisë është synim i kompanisë gjë të cilën Kompania "Çabrati" ka ngritur kapacitetet në mbulueshmëri të shërbimit në gjithë territorin e komunës së Gjakovës. Synimet e kompanisë për ndarjen në burim të mbeturinave dhe riciklimi i tyre vetëm kanë filluar prej vitit 2022 si proces i cili pritet të zhvillohet edhe më shumë në të ardhmen.

1.2 Misioni

Ofrimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave për të gjithë banorët e regjionit të Gjakovës, pa dallime fetare, racore, gjinore dhe gjeografike. Sigurimin e vetë qëndrueshmërisë financiare dhe orientimin e shërbimeve me praktikatat më të mira ndërkombëtare të kompanive publike dhe ruajtjen e ambientit për një qytet sa më të pastër.

1.3 Qëllimet e kompanisë

Qëllimet e KRM "Çabrati" Sh.A, janë që krahas ofrimit të mbledhjes së mbeturinave, pastrimit të qytetit, ofrimit të shërbimeve mortore dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit parqeve shëtitoreve dhe lumenjve, të gjitha këto me të vetmin qëllim të përbashkët: ruajtjen e ambientit dhe ofrimin e shërbimeve kualitative për qytetarët e Komunës Gjakovës.

Pra në përgjithësi këto qëllime janë konsideruar si domosdoshmëri që të arrihen nëpërmes:

- Forcimin e kapaciteteve të KRM "Çabrati" Sh.A. që të rrisë kualitetin e shërbimeve, pajisjen me mekanizim dhe automjete moderne për grumbullimin e mbeturinave,
- Modernizmin e sistemit të financave dhe kontabilitetit me anë të programeve të reja të cilat do ta rrisin cilësinë dhe kualitetin e shërbimeve të faturimit dhe inkasimit,
- Përmirësimin e kapaciteteve të personelit nëpërmes ngritjes profesionale dhe avancimin e tyre në mënyrë që t' u përgjigjen kërkesave të qytetarëve,
- Zgjerimin dhe ofrimin e kontratave të reja për konsumator, në të tri kategoritë: amvisëritë, bizneset dhe institucionet,(proces i filluar prej vitit 2021 dhe vazhdon edhe ne vitet pasuese);
- Kontakti me qytetar për kënaqshmërinë e banorëve të zonave urbane e rurale me shërbimet që ofron Kompania Çabrati, (Kompania realizon anketimin me qytetar çdo 3 mujor).
- Forcimin e bashkëpunimit me institucionet komunale lokale, Drejtorinë e Inspektionit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtoritë tjera të linjës, në mbarëvajtjen dhe ecurinë e shërbimeve tona,
- Bashkëpunimin dhe përfaqësimin në Gjykatat e rregullta për zgjidhjen e problemeve të borxheve, respektimin e procedurave për arkëtimin e këtyre borxheve,
- Kooperimin dhe zhvillimin e projekt-iniciativave të cilat do të forcojnë kapacitetet e KRM "Çabrati", nëpërmes marrjes së donacioneve dhe përkrahjes financiare nga agjencitë dhe organizatat të cilat operojnë në Kosovë e më gjerë.
- Bashkëpunimit në mes të KRM "Çabrati" Sh.A. dhe kompanive tjera për grumbullimin e mbeturinave të cilat operojnë në Kosovë e më gjerë përmes asociacionit PAMKOS.
- Menaxhimi i situatave në kohë pandemie trajtimi i mbeturinave mirëmbajtja e qytetit për tu përballur sa më mirë në situata emergjente.

1.4 Aktivitetet

Bazuar në planin e biznesit, ndërmarrja ka vazhduar me veprimtaritë Primare dhe Sekondare si në vijim:

- Aktiviteti operative primare: Ofrimi i Shërbimeve të Grumbullimit dhe Transporti i Mbeturinave Komunale në tërë territorin e Komunës së Gjakovës.
- Aktivitetet sekondare, të cilat bazohen në kontrata të veçanta, kryesisht me komunën:
 - Menaxhimi i Stacionit Transferimit të mbeturinave;
 - Menaxhimi i Tregut të Gjëlber në lagjen Orize Blloku i Ri;
 - Menaxhimi i Varrezave të Qytetit;
 - Menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike dhe pastrimi i rrugëve;
 - Mirëmbajtja e gjëlberimit;
 - Mirëmbajtja e hapësirave në Spitalin Rajonal Isa Grezda, Institutin e Mjekësisë së Punës, Qendrën e Mjekësisë Familjare dhe në të gjitha QMF-të.

Aktivitetet e saj, kompania i realizon përmes departamenteve operative dhe shërbimit për konsumatorë, dhe sektorëve tjerë mbështetës financiar dhe juridiko-administrativ, të cilat përbëjnë tërësinë e ndërmarrjes.

2. AKTIVITET PRIMAR I KOMPANISË

Veprimtaria primare/bazë e kompanisë është: Ofrimi i Shërbimeve të Grumbullimi dhe Transporti i Mbeturinave Komunale. Në aktivitetin primar bënë pjesë mbledhja dhe bartja e mbeturinave nga konsumatori deri në Stacion Transfer në lagjen "Ali Ibra", e pastaj transporti i tyre deri në deponite të cilat menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës KMDK.

KRM "Çabрати" Sh.A, shërbimet e mbledhjes, grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave, ka arritur që t'i kryejë në mënyrë efektive në të gjithë territorin dhe regjionin e Komunës Gjakovës, por ende mbetet sfidë mungesa e pajisjeve/makinerisë së mjaftueshme në mënyrë që shërbimet tona të cilat janë shtrirë gjatë vitit 2022 në tërë territorin e Komunës së Gjakovës, të jenë sa më kualitative dhe të realizohen në kohë reale.

Po ashtu, për të mbuluar shërbimet në largësitë e zonave rurale, duhet që të sigurohen që banorët e këtyre zonave të hyjnë në skemat e pagesave sipas tarifave të përcaktuara, gjë që do të mundësonte edhe nga ana e kompanisë të mbulojë shpenzimet e derivateve dhe atyre të fuqisë punëtorë në këto aktivitete. Gjendja në Stacionin e Transfer në pjesën e përparme nuk ka qenë e

volitshme për shkak të depozitimit të mbeturinave në një periudhë të gjatë (prej vitit 2014-2022), rrethanë që ka vështirësuar punën tonë si në pikëpamje logjistike ashtu edhe në atë financiare, mirëpo përgjatë vitit 2022 pjesa dërmuese e këtyre mbeturinave janë transferuar në Deponin kryesore të Landovices që Kompania "Çabрати" ka marrëveshje për dërgimin e mbeturinave në deponinë rajonale KMDK e cila është obligim ligjor, ndërsa pjesa tjetër e cila nuk është bartë pritet që përgjatë viti 2024 me financim nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të bëhet bartja edhe e asaj pjese të mbetur.

Pjesa e brendshme e Stacionit Transfer gjatë vitit 2022-2023 është pastruar me mjete vetanake të Kompanisë, nga ku është futur në funksion ST i mbeturinave dhe të njëjtat barten në baza ditore për në deponitë kryesore DS Mirash 90km dhe DS Landovice 30km.

Kompania ka dërguar sasi të konsiderueshme të mbeturinave gjatë vitit 2023 (22,206.50 tonelata), po ashtu ka kontribuar në aktivitetet për të parandaluar dhe mos lejuar djegiet gjatë këtij vitit (për rrethanat të cilat janë të njoftuar organet kompetente) atë pjesë e kemi pajisur me kamera të sigurisë e që tani është në monitorim 24/7 nga siguri i Stacionit Transfer.

Edhe pse me një objekt të vjetër në Departamentin e Operativës, (pronë kjo e pa definuar dhe në kontest gjyqësor me Agjencinë Kosovare të Privatizimit), me pajisje të vjetra mekanike dhe operacionale, KRM "Çabрати" Sh.A., ka bërë përpjekje maksimale që të ofrojë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave për të gjithë qytetarët e Komunës Gjakovës. Për të arritur këto shërbime, kemi arritur angazhim maksimal të stafit dhe sektorit Operativës që të mirëmbajmë pjesën teknike të makinerive dhe që shërbimet të kemi sa më cilësorë dhe në kohë reale në të gjitha zonat të cilat shërbehen nga Kompania "Çabрати".

Kryesisht duhet cekën disa synime e që kanë të bëjnë me:

- Modernizmin e pajisjeve dhe mjeteve tjera teknike.
- Ofrimin e kushteve maksimale për punë, (mbrojtjen në punë, furnizimin me rroba dhe këpucë për periudhat e verës dhe dimrit dhe mjeteve mbrojtëse e sidomos ato për bartjen e mbeturinave të rrezikshme).
- Angazhimin e personelit menaxhues në realizimin e kontratave direkte të cilat i kemi me Komunën e Gjakovës, projekteve dhe e subvencioneve të vjetra dhe të reja, të cilat si qëllim kanë rritjen e qëndrueshmërisë së kompanisë,
- Përcaktimin e indikatorëve matës në lidhje me performancën e personelit operativ dhe atij menaxhues, respektimin e parimeve të etikës dhe konfliktit të interesave, si dhe përkatësisë gjinore në kompani, aplikimin e masave stimuluese për personelin, i cili në përgjithësi ka pasur një performancë të mirë gjatë vitit 2023,
- Pjesëmarrje të vazhdueshme në trajnime dhe punëtori të cilat kanë për qëllim trajtimin e mbeturinave mirëmbajtjen e ambientit dhe të gjitha temave që lidhen me ambient.
- Pjesëmarrje aktive gjatë aktiviteteve dhe thirrjeve nga Zyra për Menaxhim të Mbeturinave në kuadër të Komunës së Gjakovës për një Gjakovë të pastër, gjatë vitit 2023 Kompania "Çabрати" ka qenë pjesëmarrëse në disa gara të cilat janë organizuar për mjedis, si dhe bashkë financuese

e garës ECO Gjakova, pjese e së cilës kanë qenë Komuna e Gjakovës, GAC-i dhe KRM "Çabrati" Sh.A.

3. AKTIVITETET SEKONDARE

3.1 Varrezat e Qytetit

Menaxhimi i shërbimit të varrimeve paraqitet si aktivitet sekondar për nga rëndësia e të hyrave në ndërmarrje. Gjatë kësaj periudhe raportuese, personeli i rregullt i angazhuar rreth varrezave të qytetit me numër ka qenë: 6 punëtor, prej tyre 1/një/ përgjegjës, 1/një/ rojtar dhe 4 /katër/ punëtorë-varrtarë të angazhuar në baza ditore, plus kemi angazhuar edhe punëtor shtesë, kur ka pasur më shumë se tre raste të varrimeve për një ditë. Ofrimi i shërbimit të varrimeve janë të koordinuar me operativën dhe zyrën për faturim/ inkasim.

Duke filluar nga 01.01.2023 e deri me 31.12.2023, kemi pasur:

1. Varrime me transport	186 copë
2. Varrime pa transport	104 copë
3. Varrime e porsalindurve	6 copë
4. Rezervime/vazhdime të kontratave	125 copë

3.2 MARRËVESHJA ME KOMUNËN E GJAKOVËS

KRM "Çabrati" Sh.A. Gjakovë, ka pasur dy marrëveshje me Komunën e Gjakovës për kryerje të punëve sekondare,

1. Marrëveshja "Për Mirëmbajtjen dhe Pastrimin e Rrugëve Publike;
2. Marrëveshje "Për Mirëmbajtja e Gjelbërimit dhe Mbjellja e Fidanëve, Drunjëve Dekorativë dhe Luleve".

Ndërsa gjatë vitit 2023 kemi nënshkruar memorandumin me Komunën dhe atë:

1. Memorandum për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale.

Në vitin 2023 të dy kontratat dhe marrëveshjen e kemi fuzionuar me një Marrëveshje gjithëpërfshirëse:

1. "Mirëmbajtja e Autorrugëve dhe Gjelbërimit ne Komunën e Gjakovës".

Kjo kontratë ka afat 1 /një/ vjeçare, dhe sipas kësaj kontrate kryhen të gjitha shërbimet të mirëmbajtjes së qytetit sipas planit dinamik, të nënshkruar nga Menaxheri i Operatives dhe komisioni të cilin e emëron Komuna e Gjakovës.

3. RAPORT MBI AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË OPERATIVES GJATË VITIT 2023

KRM "Çabrati" Sh.A, ka bërë përpjekje maksimale që të ofrojë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës. Për të arritur këto shërbime sa me

cilësore, duhen investime që të rigjenerojmë dhe optimalizojmë shpenzimet materiale dhe ato të resurseve njerëzore. Kjo kryesisht ka të bëjë me:

- Modernizimin e pajisjeve dhe mjeteve tjera teknike, (kamionët e rinj, pajisjet e reja),
- Modernizimin e Autoparkut, Oficinës (krijimi i kushteve për riparimin, servisimin dhe rregullimin e kamionëve, nuk kemi arritur ta plotësojmë për shkaqe të krijuara objektive dhe subjektive që e kanë përcjellë kompaninë dhe kanë qenë pengesë.)
- Ofrimin e kushteve për punë, (mbrojtjen në punë, furnizimin me rroba dhe këpucë për periudhat e dimrit dhe për mbrojtje ndaj pandemieve),
- Angazhimin e personelit menaxhues në aplikimin/ fitimin e tenderëve të rinj, projekteve dhe granteve të reja të cilat si qëllim kanë rritjen e qëndrueshmërisë së kompanisë,
- Përcaktimin e indikatorëve matës në lidhje me performancën e personelit operativ dhe atij menaxhues,
- Respektimin e parimeve të etikës dhe konfliktit të interesave, si dhe përkatësisë gjinore në kompani,
- Aplikimin e masave stimuluese për personelin i cili ka një performancë të mirë.
- Gjatë vitit 2023 thirrjes së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për skemat e mbështetjes financiare për Kompanitë Publike Lokale, kemi aplikuar me projekt të detajuar dhe të specifikuar për dislokimin e Operatives në pjesën e përparme të Stacionit Transfer, vlera e projektit kap shumën 120 mijë euro e cila bashkë financohet nga Komuna e Gjakovës me 20% të vlerës së këtij projektit.

KRM "Çabрати" Sh.A, ka punuar sipas Planit Operativ të aprovuar, mirëpo që ka pas ndryshime dhe është plotësuar sipas nevojave për shkak të rritjes së shërbimeve në zgjerim posaçërisht në zonat rurale total 22 fshatra gjatë vitit 2021. Sipas të dhënave që posedojmë, mesatarja ditore e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave në Landovicë ka qenë: 77.11 tonë, si vijon:

Dërgimi - deponimi i mbeturinave në Deponinë Rajonale në Landovicë nga KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë dhe faturimi nga KMDK gjatë vitit 2023 sipas muajve, sasisë dhe vlerave.

Nr.	Muaji i faturuar	Sasia në tonë e Faturuar	Vlera në euro me TVSH e Faturuar
1	JANAR	1941.86	15,33.60
2	SHKURT	1439.86	11,367.41
3	MARS	1934.54	15,272.81
4	PRILL	1723.12	13,603.69

5	MAJ	2162.26	17,070.61
6	QERSHOR	1968.3	15,539.33
7	KORRIK	2065.88	16,309.71
8	GUSHT	1810.94	14,767.38
9	SHTATOR	2322.72	21,222.01
10	TETOR	1860.32	14,686.85
11	NENTOR	1964.98	15,840.36
12	DHJETOR	1011.72	14,557.98
TOTAL		22,206.5	185,568.74

TOTALI I SASIS x 12 Muaj = MESATARJA MUJORE 1,850.55	Sasia ditore : 24= Mesatarja DITORE

Mesatarja e sasisë ditore në ton, për vitin 2023	77.11

Nga Kompania jonë zbrazen 75-95 kontejnerë 1.1 m³ në secilën ngarkesë grumbullimi i mbeturinave të amvisërisë kryhet me kamion kompaktor të specializuar për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa shërbimi kryhet derë në derë. Gjithashtu kompania ka në dispozicion edhe kamion vetëngarkues i cili përdoret për kompani të mëdha, tërheqjen e deponive të egra mbetjet nga demolimet e ndërtimit. Edhe përgjatë vitit 2023 kemi përdorur në raste të veçanta traktor për grumbullimin e mbeturinave dhe të gjësëndeve tjera të cilat ka qenë e pamundur të kryhen me kamion për shkak të papërshtatshmërisë së rrugëve dhe pjesëve të cilat ka qenë e pamundur që të kryhen me kamion të llojit që posedon kompania.

4.1. PAISJET/ MAKINERITË

– Operativa gjatë vitit 2023 ka operuar me këtë makineri:

- 4 kamionë rrotativ- me mulli, me kapacitet 7 ton;
- 9 kamionë kompaktor me kapacitet 3.5 ton;
- 3 traktorë vetëngarkues me kapacitet 2.5 ton;
- 3 kamionë kompaktor me kapacitet 10 ton;
- 2 Vet-Ngarkues me kapacitet 3.5 ton;

- 1 Kamionin pa rimorkio me kapacitet 7.5 ton, për transferimin e mbeturinave deri tek deponia rajonale në Landovicë;
- 1 Kamion me rimorkio 15 ton, për transferimin e mbeturinave deri tek deponia rajonale në Landovicë;
- Një ULTA e cila shërben për ngarkim të mbeturinave që barten për deponin kryesore në Landovicë;
- Një Skip për eliminimin e deponive të egra dhe punëve të tjera shtesë;
- 1 Kamionët e tipit T4 për nevoja e Operatives;
- 1 Kamionët e tipit T7 për kryerjen e shërbimit të rregullt
- Traktor Goldon për mirëmbajtje të parqeve dhe hapësirave gjelbëruese.
- 3 Pick Up për nevoja të kontrolles.
- 1 Automjet i përdorur për bartjen e kufomave.
- 1 Automjet Pasat vetur
- 1 Kamion Cistern për spërkatje dhe larje.
- 2 Auto-Fshesa - 2500
- 1 Autofshese nga Grandi i Performances.

Lista e automjeteve të kompanisë KRM Çabrat

Nr. Rendor	Lloji Automjetit	Numri identifikues	Regjistrimi	Kapaciteti
1	IVECO	WJMA1VPU00CO94329	07-296-BN	12000
2	IVECO	WJMA1VPU00CO93915	07-297-BN	12000
3	IVECO	WJMA1VPU00CD94251	07-865-AG	12000
4	MERCEDES AUTONGARKUES	WDB65213715739797	07-952-BK	10964 cm 3
5	MERC.ECONIK I GJELBERT	WDB9576561V212225	07-968-DR	6374 cm3
6	MERCEDES ECONIK	WDB9576601V211204	07-169-DR	7201 cm 3
7	MAN-H18 - TGA	WMAH18ZZV6W061557	07-862-EA	10518 cm 3
8	RIMORKIO HKA - 18.70	W09HKA1870XH15506	07-110-TA	/
9	MAN-H18 I BARDH	WMAH18ZZ35M404834	07-144-DD	10518 cm 3
10	MERCEDES BENZ – 817	WDB6760671K128760	07-906-EH	5958cm3
11	HYUNDAI	KMFGA17HEB0001337	07-324-BE	3933 cm3
12	HYUNDAI	KMFGA17HEB0001291	07-865-AN	3933 cm3
13	HYUNDAI	KMFGA17HEB0001173	07-873-AN	3933 cm3
14	VW H7 TRANSPORTER	WV1ZZZ7Z7X008358	07-624-DN	2461 cm 3
15	SKIP	31031454	07-149-VA	4987 cm 3
16	ULTA	Y0808012YH0808011	NUK KA	/
17	TRAKTOR IMT	546398	07-113-VA	2500 cm3
18	TRAKTOR IMT	501303468	07-112-VA	2500 cm3
19	TARKTOR IMT	53303101	0938-KS	2500 cm3
20	MERCEDES KOMPAKT. 1017	3.80113E+13	07-671-DF	6374 cm3
21	PASSAT	VWVZZZ3BZXE425617	07-891-AG	2496 cm 3

22	MERC.CISTERN SPERKATESE	WDB61702415477803	07-894-CO	10964 cm 3
23	GOLDON	01-10-4-12-0102	NUK KA	/
24	VOLKSWAGEN - VW CADDY	WV1ZZZ2KZ4X016676	07-865-EJ	1968 cm3
25	VOLKSWAGEN - VW 2KN	WV1ZZZ2KZ5X049316	07-912-EJ	1969 cm3
26	VOLKSWAGEN - VW 2KN	WV1ZZZ2KZ8X047023	07-863-EJ	1968 cm3
27	MERCEDES - BENZ 967PKX3-M	W1T96702710546179	07-253-EM	7698 cm3
28	MERCEDES - BENZ 963-0-A	W1T96300210560425	07-254-EM	10677 cm3
29				
30	MERCEDES - BENZ 963-0-A	W1T96300210563459	07-395-EM	10677 cm3
31				
31	Autofshesa 1	1102120	NUK KA	2800 cm3
32	Autofshesa 2	1101344	NUK KA	2800 cm3
33	AUTOFSHESA 3	/	/	/
34	RENAULT MIDLUM	VF642AEA000014738	07-216-ES	4116
35	FORD CARGO	NM0LKX1P6LNB98251	07-818-EP	8974
36	WOLFSFAGEN TRANSPORTER KAMIONET	WV3ZZZ7JZ9X008866	07-874-ER	1896
37	Automjet per bartjen e kufomave	WV1ZZZ7HZ9H138138	07-936-EP	2500cm3
38	RENAULT MIDLUM	VF644AHL000003047	07-215-ES	7146
39	FORD KAMIONET	WFDAXXBDFAGY10431	07-901-ER	1998

4.2 KRM "Çabрати" Sh.A operon në këto orar:

- Ndërrimi i parë fillon nga ora 07:00 dhe mbaron afërsisht në ora 15:30.
 - Mes ndërrimi fillon shërbimin me një automjet në ora 12:00 - 20:00.
 - Ndërrimi i tretë prej orës 19:00 deri 01:00 pas mesnate, ndërsa gjate sezones verore kur kemi volum te shtuar te mbeturinave përfundimi i ndërrimit të tretë behet ne ora 03:00 te mëngjesit. Kamioni operon prej orës 19:00-22:00 në relacion-itinerar "Unazën e Qytetit" ku behet zbrazja e kontejnerëve publik te banesave kolektive, dhe nga ora 22:00 bënë grumbullimin e mbeturinave në shërbim të bizneseve në rrugët "B. Qaushi", "N. Tereza" dhe "Skënderbeu".
- Në vitin 2023 kemi operuar edhe me kamionet për grumbullimin e mbeturinave ne rrugën Bardhyl Qaushi, Nena Terezë dhe Skënderbeu.

5. SEKTORI PËR INKASIM/ FATURIM dhe MARRËDHËNIE ME KONSUMATORË

➤ *Struktura dhe numri i klientëve të shërbyer gjatë vitit 2023*

Viti	Amvisëri	Biznes i vogel	Biznes i madh	Institucione	Jorezident	Tregu	Totali
2023	14,385	2,250	220	73	2,531		18,463

Numri i paraqitur i klientëve të shërbyer është raporti i faturimit të muajit Dhjetor 2023, si dhe tek jo rezidentët është paraqitur numri total i klientëve pasi te njëjtit faturohen vetëm një herë në vit.

➤ **Numri i klientëve të ri të shërbyer gjatë vitit 2023**

- ✓ Amvisëri 679 konsumatorë të rinj;
- ✓ Jo rezident 339 konsumatorë të rinj;
- ✓ Biznes i vogël 119 konsumator të rinj;
- ✓ Biznes i madh 15 konsumator të rinj;
- ✓ Tregu 12 konsumator të rinj;
- ✓ Totali për vitin 2023, 1,164 konsumator të rinj.

Raporti sipas të dhënave të siguruara nga programerët, e programit softuerik RIKONT

➤ **Faturimi dhe inkasimi për vitin 2023, i shprehur në vlerë dhe përqindje (%)**

Kategoritë	Faturimi	Inkasimi	%
Amvisëri	856,295.00€	853,999.04€	99.73 %
Biz. Vogel	207,353.40€	205,713.51€	99.21 %
Institucione	406,715.63€	542,186.38€	133.31%
Biz. i Madh	168,019.90€	175,511.89€	104.46%
Shërbime Varrimi	38,495.96€	38,495.96€	100.00%
Shërbime tjera	8,947.40€	8,947.40€	100.00%
Jo rezident	37,545.00€	16,953.46€	45.16%
Tregu	6,885.00	5,235.00	76.03 %
Shitja-Ankand	9,067.00	9,067.00	100.00 %
Totali	1,739,324.29€	1,856,109.64€	106.71%

Të dhënat e paraqitura i takojnë raportit të datës 09.01.2024, pas formimit të faturave të kuvendit komunal për mirëmbajtje të rrugëve dhe gjelbërimit për muajin Dhjetor 2023 dhe pas regjistrimit të të gjitha pagesave të kryera përmes bankës për klientë që kanë paguar deri me datë 31.12.2023.

Në tabelën e lartcekur janë paraqitur të dhënat mbi vlerat e faturimi-inkasimit total për vitin fiskal 2023, nga ku përfshihen faturim-inkasimi për amvisëri, biznes i madh dhe biznes i vogël, institucione dhe faturat e Kuvendit Komunal sipas kontratave për mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe pastrimin e rrugëve, po ashtu edhe shërbime e varrimit dhe shërbimet e veçanta, shërbime speciale të cilat kompania i ofron për konsumatorët si dhe tregu ku hyn dhënia në shfrytëzim të tezgave dhe ankandi nga shitja e aseteve të dalura jashtë përdorimit, përderisa në tabelën e poshtëshënuar paraqitet përqindja e inkasimit krahasuar me faturimin sipas muajve të vitit fiskal 2023.

Inkasimi në përqindje sipas muajve ka qenë:

1. Janar 2023.....	65.73%
2. Shkurt 2023.....	182.65%
3. Mars 2023.....	87.37%
4. Prill 2023.....	67.85%
5. Maj 2023.....	122.24%
6. Qershor 2023.....	124.40%
7. Korrik 2023.....	83.46%
8. Gusht 2023.....	106.20%
9. Shtator 2023.....	83.46%
10. Tetor 2023.....	85.91%
11. Nëntor 2023.....	222.19%
12. Dhjetor 2023.....	99.63%

Vlen të theksohet që nga muaji Janar 2022 kompania ka filluar për herë të parë me aplikimin e tarifës për konsumatorët apo kategorinë JOREZIDENT e cila sipas vendimit të kuvendit komunal për caktimin e tarifave të grumbullimit të mbeturinave është caktuar të jetë 15.00 Euro vjetore.

Tek kjo kategori gjatë vitit 2023 janë kategorizuar gjithsej 1,917 konsumatorë prej të cilëve disa kanë qenë klientë ekzistues por që faturimi për të njëjtit është kryer duke aktivizuar dhe pasivizuar faturën, por që kemi numër të konsiderueshëm edhe të konsumatorëve të rinj të regjistruar gjatë vitit 2022-23 që i takojnë kësaj kategorie, përderisa për kategoritë e tjera të klientëve faturimi ka vazhduar me të njëjtat vlera/tarifa sikurse vitin paraprak.

Inkasimi total për periudhën Janar – Dhjetor 2023 ka qenë si vijon:

- 106.71 % Inkasimi total për periudhën Janar – Dhjetor 2023;
- 133.31 % Inkasimi nga Institucionet dhe Kuvendi Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2023

Nga muaji Janar 2023 kompania ka filluar me menaxhimin e Tregut të gjelbër në lagjen Orize ku gjithsej 30 tezgja janë dhënë në shfrytëzim të ndara në dy kategori.

Në kategorinë e parë hyjnë tezgat e shfrytëzuara 7/7 ditë dhe kategoria e dytë ku tezgat shfrytëzohen 1/7 ditë.

Gjatë vitit 2021 K.R.M. "Çabrati" Sh.A., ka arritur me sukses të bëjë shtrirjen e shërbimeve në grumbullimit e mbeturinave në 22 /njëzet e dy/ fshatra ku më parë nuk ka ofruar shërbim dhe ka regjistruar në listat e shërbimeve konsumatorë të rinj me kontrata te reja.

6. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2023

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar ne Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRM "Çabrati" Sh.A. si Autoritet Kontraktues është i obliguar për çdo vit kalendarik të përgatis dhe të dorëzoj në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) Raportin vjetor të Kontratave të nënshkuara publike, raport ky që dorëzohet jo me vonë se data 15 Janar e çdo viti kalendarik. Ky raport hartohet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për prokurim publik duke paraqit në detaje aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor. Në raport përfshihen aktivitetet e prokurimit publik sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteve të prokurimit si dhe procedurave të prokurimit.

2. KORNIZA LIGJORE

Zyra e prokurimit aktivitetin, kompetencat dhe përgjegjësit e saj i ushtron në kuadër të Ligjit (në fuqi) për prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Sektori i prokurimit, aktivitetin e saj në fushën e prokurimeve e bazon në parimet e ekonomizimit dhe të transparencës si dhe në atë të barazisë në trajtim jo-diskriminimit dhe efikasitetit të ushtrimit aktiviteve të prokurimeve. Zyra prokurimit dhe Zyrtari përgjegjës i prokurimit siguron dhe është përgjegjës që:

- a) Në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetor të prokurimit.
- b) Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive;
- c) Për aq sa mundet, siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrence;
- d) Këshillon njësitë kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit;
- e) Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Parallogaritë dhe vizatimet;
- f) Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit;
- g) Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve;
- h) Partecipon në Negocime të Tenderëve dhe siguron rezultate të drejta;
- i) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues;
- j) Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar;
- k) Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht
- l) Kur ndodhin mosmarrëveshje, dëme në mallra, dorëzime të tepërta ose të mangëta, dështim në përfundim ose komplikime tjera relevante, ruan të gjitha komunikimet dhe dëshmitë relevante të pranuar;
- m) Përcjellë dështimet e kontraktorëve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave;
- n) Prodhon një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkuara

3. AKTIVITETI PËR PERIUDHEN RAPORTUESE

Zyra e prokurimit për çdo vit kalendarik në konsultim me të gjitha departamentet përgatit Planifikimin paraprak të prokurimit dhe ia dorëzon Kryeshefit Ekzekutiv me shkrim për miratim. Pas miratimit të buxhetit për vitin fiskal Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit publikohet në ueb-faqen e kompanisë dhe i njëjti dorëzohet në Agjencinë Qendrore të Prokurimit – AQP përmes platformës elektronike. Si Autoritet Kontraktues me datë 10 Janar 2024 kemi dërguar në mënyrë elektronike përmes sistemit të e-prokurimit Planifikimin Përfundimtar të prokurimit për vitin 2024

Zyra e prokurimit në fund të secilit vit fiskal përgatit dhe dorëzon në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik- KRPP një raport vjetor për kontratat e nënshkruara. Si Autoritet Kontraktues me datë 15 Janar 2024 kemi dërguar përmes postes elektronike Raportin vjetor të Kontratave të nënshkruara publike për vitin 2023

Planifikimi prokurimit për vitin 2023

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT PER VITIN FISKAL 2023	
Furnizime	18
Shërbime	11
Punë	3
VLERA TOTALE E PLANIFIKIMEVE	1,352,256.34
Furnizim	1,180,892.34
Kontratë për shërbime	81,364.00
Kontratë për punë	90,000.00
AKTIVITETET E PLANIFIKIMIT TË REALIZUARA	
Furnizim	10
Shërbime	6
Punë	0
VLERA E PLANIFIKIMIT E REALIZUAR	
Furnizim	423,716.69
Shërbime	27,455.00
Punë	0.00
AKTIVITETET E PROKURIMIT TE PAREALIZUARA	
Furnizim	8
Shërbime	5
Punë	3
VLERA E AKTIVITEVE TE PROKURIMIT TE PAREALIZUARA	
Furnizim	152,438.34
Shërbime	43,280.00
Punë	90,000.00
AKTIVITETET E PROKURIMIT TE PAPANIFIKUARA TË REALIZUARA	
Furnizim	0
Shërbime	2
Punë	0
VLERA E AKTIVITEVE TE PROKURIMIT TË PAPANIFIKUARA TË REALIZUARA	

Furnizim	0.00
Shërbime	3,475.81
Punë	0.00

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA TË PAREALIZUARA 2023
KONTRATAT PËR FURNIZIME

Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Arsyetimet nga Njësitë kërkuese për mos dorëzimin e kërkesës për procedim të aktiviteteve të prokurimit
1	Furnizim me Automjet - Veturë-e përdorur	14.03.2023	25,000.00	Ky aktivitet nuk është realizuar për shkak që nuk është konsideruar i nevojshëm për këtë vit dhe për këtë arsye kalon në vitin pasues si kërkesë e prokurimit.
2	Furnizim me traktor	22.03.2023	17,000.00	Ky aktivitet nuk është realizuar për shkak që gjatë vitit 2023 kemi furnizuar me kamion madhësisë 1.5T që kanë arritur të zëvendësojnë automjetet të llojit traktor. Si aktivitet kalohet për vitin pasues 2024.
3	Furnizim me Eskavator (SKIP)- I përdorur	12.04.2023	50,000.00	Ky aktivitet nuk është realizuar për faktin që Eskavatori të cilin e kemi përdorur është rregulluar me me pak mjete financiare dhe është bërë i gatshëm plotësisht për punë operative.
4	Furnizim me Inventar zyre	19.04.2023	2,700.10	Për shkak se nuk kemi pasur kërkesa nga sektorët për furnizim me inventar, andaj nuk do të iniciohet kërkesa nga njësia kërkuese për këtë vit.
5	Furnizim me pjesë rezervë për automjete	26.04.2023	36,988.00	Ky aktivitet nuk është realizuar për shkak që pas hulumtimit të tregut kemi konstatuar që ka ngritje të çmimeve dhe nuk janë përshtatur me shumën e planifikuar. Si aktivitet kalohet në vitin pasues.
6	Furnizim me Kamion - Kiper 3.5 ton i përdorur për Riciklim	10.05.2023	15,000.00	Në bazë të analizave të sektorit të operativës kemi ardhë në përfundim që në bazë të makinerisë që posedojmë për këtë vit nuk ka qenë e nevojshme pasi që është kaluar deri në rishikim dhe përpilim të planit të ri operativ.
7	Furnizim me pajisje të teknologjisë informative	06.09.2023	2,750.00	Për shkak se në vitin e kaluar (2022) është bërë furnizimi me pajisje të IT, nuk kemi pasur kërkesa nga asnjë sektor për këtë prokurim, andaj edhe nuk do të iniciohet kërkesa për këtë vit.

8	Furnizim me material zyrtar	18.10.2023	3,000.24	Nuk është inicuar dhe nuk do të iniciohet në këtë vit, për shkak se kontrata e fundit ka skaduar nëmuajin Nentor 2023. Kështu që me pjesën e tepruar/pa shfrytëuar të kontratës në fjalë, jemi furnizuar me material edhe për muajin dhjetor 2023. Andaj, meqenese jemi në përfundim të vitit 2023, nuk e kemi konsideruar të nevojshme iniciimin e këtij prokurimi, duke marr parasysh se të njëjtin prokurim e kemi të planifikuar edhe për vitin 2024.
Totali i vlerës			152,438.34	

KONTRATAT PËR SHËRBIME

Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Arsyetimet nga Njehsitë kërkuese për mos dorëzimin e kërkesës për procedim të aktiviteteve të prokurimit
1	Shërbime informative të radios	13.01.2023	1,440.00	Nuk është konsideruar i nevojshëm ky shërbim, andaj edhe nuk do të iniciohet kërkesa për këtë prokurim në këtë vit.
2	Sigurimi dhe kontrolla teknike e automjeteve	20.01.2023	16,840.00	Ky aktivitet nuk është realizuar për shkak që kemi kontaktuar kompani dhe kemi hulumtuar tregun mirëpo është konstatuar që si aktivitet për momentin nuk mund të zhvillohet për shkak të luhatjeve kohë pas kohe të crimeve në treg. Si aktivitet kalon në vitin 2024.
3	Bartja e kontejnereve zyre nga Stacioni Policor Gjakove në objektin e Operatives - Stacioni transfer i mbeturinave	02.03.2023	20,000.00	Ky aktivitet nuk ka qenë e mundur të zhvillohet për shkak që pjesa e Stacionit Transfer ku është planifikuar të vendosen kontejneret nuk është pastruar plotësisht gjë që na e ka bërë të pamundur të zhvillojmë procedura tenderuese për bartje në mungesë të hapësirës për vendosje.
4	Ribrendimi i kompanisë	13.06.2023	5,000.00	Nuk ka mjete të mjaftueshme për këtë prokurim, andaj nuk do të iniciohet kërkesa për këtë prokurim në këtë vit.
5	Auditim i jashtëm (Deklaratave financiare)	29.11.2023	6,012.00	Është realizuar sipas PPP të vitit 2022 në fund të Dhjetorit (3 vite) dhe për siguri është vendos edhe në PPP të vitit 2023
Totali i vlerës			43,280.00	

KONTRATAT PËR PUNË

Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Arsyetimet nga Njehsitë kërkuese për mos dorëzimin e kërkesës për procedim të aktiviteteve të prokurimit
1	Renovimi dhe mirëmbajtja e hapësirave në objekte	14.04.2023	20,000.00	Nuk ka mjete të mjaftueshme për këtë prokurim, andaj nuk do të iniciohet kërkesa për këtë prokurim në këtë vit.
2	Rregullimi i tregut Orize	03.05.2023	20,000.00	Nuk ka mjete të mjaftueshme për këtë prokurim, andaj nuk do të iniciohet kërkesa për këtë prokurim në këtë vit.
3	Renovimi i objektit të Operatives - Stacionit transfer të Mbeturinave	23.05.2023	50,000.00	Si aktivitet i prokurimit i paraparë për vitin 2023 nuk është realizuar për shkak që ndërlidhet me aktivitetin tjetër të prokurimit "Bartja e kontenjerve zyre nga Stacioni Policor Gjakovë" andaj është kaluar për vitin tjetër.
Totali i vlerës			90,000.00	

AKTIVITETE TË PAPANIFIKUARA TË REALIZUARA 2023 KONTRATAT PËR SHËRBIME

Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Data e inicimit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Arsyetimet nga Njehsitë kërkuese për inicim të aktivitetit të prokurimit të paplanifikuar.
1	Hartimi i elaboratit të shkarkimit të ujërave	14.02.2023	2,500.00	Ky aktivitet i prokurimit nuk ishte parashikuar në Planifikim të Prokurimit për vitin fiskal 2023. Mirëpo për shkak se jemi në proces për pajisje me Leje Mjedisore në MMPH, nga e njejta Ministri na është kërkuar që të posedojmë Lejen ujore, për një afat kohor prej 45 ditësh. Në mënyrë që të procedojmë tutje për tu pajisur me Leje Mjedisore për stacionin transfer të mbeturinave jemi të detyruar të procedojmë me këtë aktivitet të prokurimit.

2	Vleresimi i pasurise dhe aseteteve te kompanise	06.10.2023	990.00	Ky aktivitet i prokurimit nuk ka qenë i përfshirë sepse sipas kërkimeve të bëra në treg kemi pranuar informacione se një kerkese e tillë mund të ketë kosto të lartë financiare.
Totali i vlerës			3,490.00	

QASJE NE DOKUMENTE ZYRTARE	
Uniforma dhe mjete mbrojtëse per pune- KRMC-23-1340-1-2-1	"RIMI ALTEX"sh.p.k
Uniforma dhe mjete mbrojtëse per pune- KRMC-23-8884-1-2-1	"RIMI ALTEX"sh.p.k
Furnizim me pjesë hidraulike (pompa, komanda, reduktor dhe gypa) - KRMC-23-11072-1-2-1	"BOJKU HIDRAULIK"sh.p.k
KERKESA PER RISHQYRTIM	
Uniforma dhe mjete mbrojtëse per pune- KRMC-23-1340-1-2-1	"RIMI ALTEX"sh.p.k
ANKESA NE OSHP	
Uniforma dhe mjete mbrojtëse per pune- KRMC-23-1340-1-2-1	"RIMI ALTEX"sh.p.k
SHITJE TE ASETETEVE DHE MATERIALIT TE DALUR JASHTE PERDORIMIT	
Vlera e parashikuar e shitjes	10,357.90
Vlera e realizuar e shitjes	9,067.00
PJESEMARRJE NE TENDER SI OPERATOR EKONOMIK	
Mirëmbajtja e hapësirave të jashtme (oborrit) të Spitalit -70020-23-9657-2-3-6/C176	8,428.20
NJOFTIME NGA KRPP	
Publikimi Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik dhe i cili ka hyrë në fuqi nga data e publikimit me 01.02.2023.	01.02.2023
Përditësimi i "Manualeve për përdoruesit e AK dhe OE" lidhur me funksionet e reja në Sistem të Prokurimit Elektronik "Kërkesat për rishqyrtim" dhe "Ankesat.	29.03.2023
Aplikimi i paragrafeve 19.7, 19.8 dhe 19.9 të Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurimin Publik. Ndalohen prokurimet të cilat referohen në listën e sanksioneve ligjore të caktuara nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës, sipas Vendimeve: 01/64 të datës 25.02.2022 , dhe vendimeve 02/78, 03/78, 04/78 të datës 16.05.2022 , dhe të listuara në faqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës: https://mfa-ks.net/sanksionet-ligjore/ Kjo listë do të përditësohet vazhdimisht në bazë të vendimeve të Qeverisë ose institucioneve referente ndërkombëtare.	14.04.2023
Njoftim per ndryshim dhe plotësim te listës së artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik, e aprovuar sipas pikës 1. te Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30 prill 2020, me listën e bashkëngjitur në Shtojcën 1. të këtij Vendimi	28.04.2023
Njoftim për të gjitha autoritetet kontraktuese lidhur me publikimin e "dokumenteve shtesë" në një procedurë të prokurimit	02.08.2023
Publikimi i DORACAK PËR PËRDORIMIN E KRITERIT TË SHPËRBLIMIT "Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF)"	15.09.2023

4. REKOMANDIMET/SFIDAT E ZYRES PROKURIMIT

Adresimi i sfidave dhe rekomandimeve

Sfidat	Detyrat dhe përgjegjësitë	Problematika	Rekomandimet
Planifikimet e prokurimit	<p>Planifikimi i prokurimit duhet të jetë konform buxhetit të AK për vitin fiskal në fjalë.</p> <p>Për një planifikim të mirë të prokurimit zyrtarit të prokurimit i nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Zyrtari i prokurimit do të takohet me personat përgjegjës për buxhet dhe departamentet që bëjnë kërkesat (përdoruesit) dhe të diskutojë kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin e ardhshëm dhe do të vendosë cilët artikuj të përfshihen në planifikimin paraprak dhe final të prokurimit.</p> <p>Brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal, secili AK, i cili është autoritet publik ose ndërmarrje publike, do të përgatit, do të publikoj në web faqen e Autoritetit përkatës Kontraktues dhe të njëjtin do të dorëzoj në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, këtu e tutje "AQP" Planifikimin Final të Prokurimit</p>	<p>Nuk ka pasur specifikim adekuat dhe në kohë të kërkesave nga Njehsitë kërkuese.</p> <p>Cila njësi kerkuese dhe specifikisht</p> <p>Vlera e parashikuar apo buxheti i nevojshëm për realizimin e aktivitetit shpesh ka qenë i pasaktë</p> <p>te specifikohen cilat aktivitete vlera apo buxheti ka qene i pasakt</p> <p>Vonesë në dorëzimin e kërkesave për planifikim të prokurimeve</p>	<p>Njehsitë kërkuese të kenë parasysh rekomandimet dhe të përmirësojnë kërkesat bashkë me specifikat teknike dhe vlerat e buxhetuara për ato kërkesa</p> <p>Të dorëzojnë në kohë tek ZKA dhe ZP që të ketë mundësi të përshtaten edhe me Plan Biznes.</p>
Njehsite kerkuese	<p>Njësia e Kërkesës, e cila është iniciues e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit, ka përgjegjësitë në vijim:</p> <p>a) Përgatit një kërkesë të prokurimit, vlerësimin formal të nevojave (DNPDP), dhe përcjellë këto të ZKA për aprovim;</p> <p>b) Përgatit/proponon specifikime teknike (ST), Termat e Referencës</p>	<p>Disa njësi kërkuese nuk dorëzojnë me kohë kërkesat e tyre ose i dorëzojnë pa specifikuar në nivel të duhur ato sikur edhe japin të dhëna kontradiktore për buxhetin e nevojshëm.</p>	<p>Njehsitë kërkuese të kuptojnë rëndësinë dhe të jenë të përgjegjshëm në realizimin e kërkesave.</p>

